



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 2575/24, datë 18.12.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13/29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Ua 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baqelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 132 të mbajtur më datë 09 dhe 10.12.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet** kërkesa e Kolegjit Heimerer kampusi kryesor në Prishtinë Nr.2384/24 datë 20.11.2024 për zgjatjen e periudhës së validimit të akreditimit edhe për **një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2026 - 30 shtator 2027)** për programet e studimeve:
 1. Infermiera - Praktika e Avancuar Infermierore (ANP), MSC, 120 ECTS (A);
 2. Shkencat Mjekësore Laboratorike, MSC, 120 ECTS (A);
 3. Shkencat Shëndetësore për Profile Terapeutike (SHSHPT), BSC, 180 ECTS, me specializim në: (Logopedi dhe Ergoterapi) (R).
- II.** Zgjatja e validimit të akreditimit bëhet me kushtet dhe kriteret e njëjta të përcaktuara me vendimin e KShC-së Ref.:3034/21 datë 12.08.2021.
- III.** Institucioni i Arsimit të Lartë - Kolegji Heimerer mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të vendimit KShC-së Ref.:3034/21 datë 12.08.2021 dhe të këtij vendimi.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Heimerer ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) Nr.2384/24 datë 20.11.2024 për zgjatjen e periudhës së validimit të akreditimit edhe për **një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2026 - 30 shtator 2027)** për programet e studimeve:

1. *Infermiera - Praktika e Avancuar Infermierore (ANP), MSC, 120 ECTS (A);*
2. *Shkencat Mjekësore Laboratorike, MSC, 120 ECTS (A);*
3. *Shkencat Shëndetësore për Profile Terapeutike (SHSHPT), BSC, 180 ECTS, me specializim në: (Logopedi dhe Ergoterapi) (R).*

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 132-të, të mbajtur më datë 09 dhe 10.12.2024 ka shqyrtuar kërkesën dhe duke u bazuar në arsyeshmërinë e kërkesës, në të cilën Kolegji ka ofruar: dëshmi faktike dhe juridike me të cilat është ishte akredituar/riakredituar Kolegji.

Kërkesa është bërë për vazhdimin e validimit të 3 programeve të studimit deri më 30 shtator 2027, bazuar në vendimin e mëparshëm të KShC-së Ref.:3034/21 datë 12.08.2021 të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe vlerësimin e EVALAG - Agjenci për Vlerësim në Baden-Württemberg, Gjermani.

Periodha e ri/akreditimit sipas Evalag për secilin program ishte 6 vite prej 09.2021 deri 09.2027.

Dëshmi: Certifikatat e bashkangjitura të ri/akreditimit programeve të lartshënuara (të bashkangjitura).


Në korrik 2021, sipas udhëzimeve, kemi bërë kërkesë në AKA/KSHC për validim të programeve në fjalë dhe më 13 gusht 2021 kemi marrë vendimin nga AXA, Nr.3034/21 të datës 12.08.2021 për validim të programeve-përperiudhë 1 I-tetor 2021, 30 shtator 2026, pra periudhë 5 vjeçare.

Meqenëse vendimi për validim Ref.:3034/21 datë 12.08.2021 ishte lëshuar për periudhën 5 vjeçare, pra 1 vit më pak se sa akreditimi nga Evalag, është bërë duke u bazuar në nenin 19 të UA 15/2016 për akreditimin e IAL-ve në Republikën e Kosovës e cila thotë "*Kohëzgjatja e akreditimit programeve është jo më shumë se pesë (5) vjet*", dhe tani edhe me Ligjin nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, përkatësisht me nenin 35, paragrafin 2. "*Kohëzgjatja e riakreditimit të programit është tre (3) ose pesë (5) vjet*".

KShC tani ka marrë parasysh vlerësimin e Evalag-ut dhe ka vendosur që të zgjatet edhe për një (1) vit validimi i akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 132 të mbajtur më datë 09 dhe 10.12.2024, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin relevant të Kolegji Heimerer dhe duke u bazuar në kërkesën, dispozitat ligjore të lartës cekura dhe kompetencat, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*



Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Heimerer;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.